



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit të Komunës
Nr. 02/Zyrtarisht
Datë: 20.06.2022

Bazuar në nenin 34, pika 12 të Ligjit Nr. 06/ L-114 për Zyrtarë Publikë dhe nenin 18, pika 1 dhe 2, paragrafi 2.3 të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Komuna e Deçanit shpall këtë :

SHPALLJE PUBLIKE

Ekspert i jashtëm në fushën e përzgjedhjes /vlerësimit të burimeve njerëzore nga organizata të specializuara apo universitetet.

Vendi i Punës: Komuna e Deçanit

Pagesa fikse është 250 euro e cila paguhet për secilën procedurë të konkurrimit për ekspertin e angazhuar.

Mandati i ekspertit është: dy (2) vjeçar.

Detyra e ekspertit është:

Eksperti i jashtëm do të jetë anëtar i Komisionit për Pranim në Shërbimin Civil dhe do të kryej detyrat e tij ashtu siç janë përcaktuar në Rregulloren Nr. 16/2020 për Pranim në Karrierë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kriteret :

- Diplomë universitare me të paktën 240 kredi -për edukimin e marr jashtë vendit duhet të bëhet nostrifikimi i diplomës;
- Të ketë përvojë pune të paktën katër (4) vite në Universitet apo organizata të specializuara;
- Të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit;
- Të kenë integritet moral dhe profesional;
- Të mos kenë qenë të dënuar penalisht për kryerjen e një vepre penale;
- Të mos jetë i punësuar në Shërbimin Civil, të mos jetë i larguar nga Shërbimi Civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

Të interesuarit aplikacionit duhet t'ia bashkëngjisin këto dokumente :

- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e diplomës të noterizuar;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Dëshmi që nuk është i dënuar penalisht për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Deklaratë se nuk ka qenë anëtarë i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pese (5) vitet e fundit;
- Deklaratë se nuk është i punësuar në Shërbimin Civil, të mos jetë i larguar nga Shërbimi Civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën Pritëse.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 8 (tetë) ditë nga data: 21/06/2022 deri më 28/06/2022.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim. Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret hyjnë në listën e ngushtë dhe njoftohen përmes tabelës së shpalljeve publike dhe telefonit.



Kryetari i komunës:


Bashkim RAMOSAJ